



Datë: 19.06.2025
Numër Protokoli: 4194/2025

A.nr.911/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.911/2025, të datës 20.05.2025, të parashtruar nga ankuesja.A.G, kundër organit të punësimit/Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.911/2025, e datë 20.05.2025, e parashtruar nga ankuesja A.G.

A r s y e t i m

Ankuesja A.G(*tutje referuar ankuesi*), më datë 19.05.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.911/2025, kundër Njoftimit të datës 02.05.2025 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit për refuzimin e aplikacionit, lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017250 për grupin ligjor pozita *Zyrtar Ligjor*, i shpallur nga Komuna e Prizrenit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 23.05.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa, kjo e fundit më datë 02.06.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se Komuna e Prizrenit, më datë 20.03.2025, ka shpallur konkursin me numër të referencës: RN00017250, për grupin ligjor, pozita *Zyrtar Ligjor*, me afat aplikimi nga data 21.03.2025 deri më datë 19.04.2025.

Tutje sipas provave të lëndës, ankueses sipas Njoftimi të datës 02.05.2025 të Njësisë për

Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit i është refuzuar aplikacioni pe arsyetimin se *ka bashkangjitur letërnjoftimin me afat të skaduar..*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Njoftimit të datës 02.05.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit, për refuzimin e aplikacionit, pretendon se është dokumentet tjera kanë qenë të kompletuara ndërsa kam pranuar letërnjoftimin e ri, dhe refuzimi i aplikacionit për një dokument që është i rinovuar është jo proporcional. Kërkon që vendimi të rishqyrtohet dhe të mundësohet vazhdimi në fazat tjera të rekrutimit.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 i cili përcakton se: *“12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit Në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankueses e parashtruar më datë 20.05.2025, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtror ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses të datës 20.05.2025, nuk kishte përfunduar procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017250, sepse njoftimi përfundimtar është publikuar më datë 26.05.2025, rrjedhë se ankesa e ankueses me numër A.nr.911/2025, e datës 20.05.2025, është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.911/2025, nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.911/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses A.G;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*